

INPO

Iniciativa për progres

Rr/Str "Ahmet Kaciku" – No:35, Kati V
70 000 Ferizaj, Kosova
Office: 0290 329 400
Mob: +37744-746-749 | +377 44-656-470
E-Mail: info@inpo-ks.org
www.inpo-ks.org

RAPORT VLERËSUES MBI PUNËN E KRYETARIT TË FERIZAJT

GJASHTË MUAJ ME FERIZAJN EVROPIAN

DRRAHE

GJASHTË MUAJ ME FERIZAJN EVROPIAN

Zgjedhjet e jashtëzakonshme në Ferizaj, sollën në krye të komunës z.Agim Aliu. Pa ndonjë platformë, ai vazhdoi mandatin qeverisës të Bajrush Xhemailit, i cili me një vendim të Gjykatës Supreme u dënua me 2.5 vjet burg, shkak i një aksidenti në komunikacion, i cili la të vdekur një person.

Në fushatën zgjedhore z.Aliu, ndonëse e kishte të qartë se po e vazhdonte një mandat qeverisës prej 1.5 vjet, prezantoi para elektoratit një listë të gjatë premtimesh, ndër të cilat janë edhe këto:

- Përkushtimi për një Ferizaj evropian
- Qeverisje transparente
- Zhvillim ekonomik dhe krijim të vendeve të reja të punës
- Administratë profesionale
- Funksionalizimin e bifurkacionit
- Investime për jetë më të mirë të të rinjëve
- Ndërtimin e një stadiumi
- Investime të reja në kulturë dhe shëndetësi

INPO, vlerëson se gjatë kësaj kohe, pra për gjashtë muaj, nuk janë dhënë indikacione për plotësimin e premtimeve elektorale. Kryetari nuk ka prezantuar ndonjë strategji apo plan për realizimin e këtyre premtimeve. Për më tej, ai ka vazhduar që qeverisjen e tij ta mbështes në platformën e trashëguar nga pararendësi Xhemaili.

Çështje esenciale në këtë mandat të mbetur të kreut të Ferizajt është se kush e qeveris realisht Ferizajn dhe kush e cakton agjendën e të parit?!

KABINETI I KRYETARIT

Kryetari i porsazgjedhur. qysh në fillim të mandatit u përball me sfidën e formimit të qeverisë komunale. Përkundër obligimeve që dalin nga statuti i komunës së Ferizajt (Neni 67.2 Çdo drejtori menaxhohet nga drejtori, i cili emërohet nga kryetari për të njëjtin mandat dhe shkarkohet nga kryetari) kryetari nuk e ndryshoi qeverinë e vjetër komunale dhe as nuk e konfirmoi atë si një qeveri të re. Situata komplikohet edhe më shumë kur bëhet fjalë për pozitën e nënkryetarit të komunës që e mban z. Besim Zymberi. Sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nënkryetari e ndihmon kryetarin në ushtrimin e funksioneve ekzekutive dhe vepron në emër të kryetarit në mungesë të tij. Në nëntor të vitit 2012 z. Aliu ka qëndruar për vizitë në komunën e Carloëit në Irlandë. Përpjekjet e INPO-s që ta

realizojnë një takim me zëvendësuesin e tij nuk kanë dhënë rezultat, megjithëse nënkryetarin e obligon Ligji, që t'i marrë obligimet e kryetarit në mungesë.

Kësisoj, z. Aliu nuk i ka përmbush obligimet dhe përgjegjësitë e një kryetari të zgjedhur drejtpërdrejtë nga qytetarët.

QEVERISJA TRANSPARENTE

Njëri nga premtimet e kryetarit ka qenë edhe transparenca. Gjatë kësaj periudhe kryetari është treguar i gatshëm për të komunikuar me qytetarët, mediat dhe shoqërinë civile. Mirëpo, nuk është vërejtur angazhimi për të qenë i hapur ndaj qytetarëve në marrjen e vendimeve dhe përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje. Në këtë kontekst, Aliu transparençën e ka shpërfaqur kryesisht nëpërmjet formës mediale, duke vizituar punëtorët shëndetësor, bizneset dhe sportistët, por duke përjashtuar rolin e qytetarëve nga procesi i politikbërjes.

Transparenca nënkupton edhe paraqitjen financiare. Kryetari si palë raportuese i përcaktuar edhe me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale (Neni 58 pika j), nuk ka prezantuar raport 9 mujor para Kuvendit Komunal për situatën ekonomike-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës.

Gjithashtu kryetari nuk është treguar i gatshëm të ofroj qasje në dokumentet publike, siç është i obliguar me ligj. Ai ka refuzuar kërkesën e INPO-s për qasje në vendimet e drejtorëve komunal për periudhën gusht-shtator 2012, me arsyetimin se Kryetari i komunës dhe Kuvendi Komunal janë organe, të cilat marrin vendime. INPO konsideron se ky arsyetim është i pabazë ngase Statuti i komunës së Ferizajt, në nenin 67 pika 4 përcakton se Drejtorët komunal i raportojnë rregullisht kryetarit për çështjet që janë nën përgjegjësinë e tyre dhe ofrojnë atij të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes.

MENAXHIMI ME BUXHETIN

Kryetari ka trashëguar buxhetin për vitin fiskal 2012 në të cilin janë përcaktuar edhe ndarjet e burimeve financiare. Ai ka arritur që me menaxhimin e buxhetit të vitit 2012, të ulë shpenzimet në linjat e luksit, për dreka zyrtare, shpenzime të telefonisë dhe shpenzimeve për mallra dhe shërbime.

Por, në ndarjen buxhetore për vitin 2013, konstatohet se ky buxhet nuk e reflekton premtimin e kryetarit për Ferizajn Evropian që garanton mirëqenien e qytetarëve dhe aq më tepër premtimin për rishikimin e buxhetit për t'i përmbushur premtimet e dhëna gjatë fushatës elektorale.

Deri sa në buxhetin e vitit 2012 programi buxhetor për Administratën kap vlerën e 561,656.00 €, në buxhetin e vitit 2013, kjo kategori pëson ngritje në vlerën 593,010.1 € (ndryshimi 5.58%). Kategoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale në buxhetin e vitit 2012 ka vlerën e 2,609,532.00 €, kurse në buxhetin e vitit 2013 kjo kategori pëson rënie në 2,424,721.7 € (ndryshimi -7.08%), kurse kategoria e

kulturës nga buxheti i 2012-s prej 482,177.00 €, më 2013, pëson ngritje në 630,084.6 € (ndryshimi 30.68 %).

INPO mbetet e përkushtuar që të vazhdojë monitorimin nga afër të punës së ekzekutivit gjatë vitit 2013, për të parë se si do të menaxhohet paraja publike gjatë këtij viti dhe si do të ndryshojnë shpenzimet nëpër linja.

PREMTIMI PËR VENDE TË REJA TË PUNËS

Gjatë fushatës, fokusi kryesor i kryetarit Aliu është përqendruar te papunësia dhe krijimi i vendeve të reja të punës. Këto vende të reja pune, ai mëton t'i krijoj nëpërmjet ngritjes së zonave të reja industriale dhe biznesore. Sipas burimeve joformale, numri i të papunëve në Ferizaj vazhdon të jetë i lartë, llogariten rreth 26 mijë e 946 të papunë. Përballë një problemi të tillë, kryetari ka dhënë premtime dhe ide për ngritjen e mirëqenies së qytetarëve, pa pasur një strategji për zhvillimin ekonomik lokal.

Për mungesë të strategjisë, alternativa e vetme e komunës për krijimin e vendeve të punës përmes dhënies së pronave komunale në shfrytëzim të përkohshëm nga personat fizik, deri më tani nuk ka rezultuar me punësimin e qytetarëve. Ndërsa pritet që brenda vitit 2013 të punësohen rreth 300 persona.

Duke pasur parasysh mungesën e investimeve të huaja, vështirësitë për krijimin e bizneseve të reja, numrin e bizneseve që kanë mundësinë e rritjes së numrit të të punësuarve dhe numrin e lartë të atyre që kërkojnë punë, për momentin e vetmja mundësi reale që i mbetet qeverisë komunale që të realizoj premtimin elektorale është zgjerimi i sektorit publik që edhe ashtu është i mbi ngarkuar dhe me shpenzime të ngritura për vitin 2013.

ADMINISTRATË PROFESIONALE

Nën aspiratën evropiane, kryetari ka premtuar se gjatë mandatit të tij do të krijojë një administratë profesionale. Në bazë të vendimit 10/46 të qeverisë së Kosovës, në komunat e Republikës së Kosovës që kanë mbi 100 mijë banorë, një nëpunës duhet të jetë në dispozicion të 620 banorëve. Në bazë të të dhënave nga regjistrimi i fundit i popullsisë, komuna e Ferizajt ka 108.690 banorë. Sipas kriterit të vendimit të qeverisë, kufiri i numrit të të punësuarve në administratë është 175, ndërsa aktualisht administrata komunale e Ferizajt numëron 290 të punësuar.

Sipas kësaj del se buxheti i komunës së Ferizajt shpenzohet për 115 të punësuar më tepër, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në menaxhimin e buxhetit dhe duke i kontribuar mosrespektimit të kërkesave të Fondit Monetar Ndërkombëtar për zvogëlimin e numrit të të punësuarve në administratën shtetërore dhe Bashkimin Evropian për administratë profesionale, duke vënë edhe një herë në pikëpyetje përkushtimin e kryetarit për Ferizajn Evropian.

FUNKSIONALIZIMI I BIFURKACIONIT

Komuna e Ferizajt ka përfituar dy projekte nga Komisioni Evropian: atë për funksionalizimin e bifurkacionit dhe ndërtimin e një stadiumi. Por, projekti për bifurkacionin ka pësuar disa modifikime, i cili është përcjellë me rrënimin e një pjese të projektit dhe ridizajnimin e tij. Projekti ka nis të realizohet me beton dhe gurë, e më pas është rrënuar me arsyetimin se Ministria e Ambientit ka sugjeruar përdorimin e mjeteve sa më natyrale për realizimin e projektit.

Duke njohur rëndësinë jetike që ka shfrytëzimi i fondeve të Bashkimit Evropian për zhvillimin e një komune, INPO konsideron se komuna e Ferizajt me modifikimin e këtij projekti, është treguar jo serioze dhe ka dëmtuar imazhin në raport me Bashkimin Evropian.

Nga ky problem ka dal në pah se komuna e Ferizajt ka dëshmuar për mungesë të kapaciteteve për shfrytëzimin e asistencës financiare të BE-së. Ato pak projekte që i ka përfituar, gjatë hartimit të tyre nuk i ka bërë analizat e duhura në terren dhe i ka propozuar komisionit evropian një projekt, të cilin nuk e ka pasur të qartë as vet se si ta realizoj.

SEKTORI I RINISË DHE KULTURËS

Kryetari ka premtuar investime për krijimin e kushteve më të mira për të rinjtë. Nëse i referohemi buxhetit të vitit 2013 kuptojmë se shpenzimet kapitale për rini janë përgjysmuar në krahasim me mjetet që janë paraparë në kornizën afatmesme buxhetore 2012-2014. Gjatë këtyre gjashtë muajve edhe ato pak mjete financiare dedikuar sektorit të kulturës nuk u shfrytëzuan për aktivitete kulturore. Janë organizuar festivale dhe shfaqje teatrale me procedura të shpejta, ku drejtuesit e teatrit vet i kanë përzgjedhur shfaqjet dhe vetë kanë luajtur në to.

Nën patronatin e kryetarit gjatë vitit 2012 u mbajt edhe festivali "Kosovarja Këndon". Në festival kishte të ftuar nga Shqipëria, Maqedonia. Festivali nuk kishte karakter garues dhe mbeti i papërcaktuar nëse u mbajt festival apo ndonjë koncert artistik.

Kryetari e ka mbështetur financiarisht pjesëmarrjen e katër studentëve në Akademinë Ndërkombëtare të Debatit në Slloveni

MUNGESA E PLANEVE

Përballë shumë sfidave për zhvillim ekonomik, qeverisje të mirë dhe mirëqenie, aktualisht platforma e vetme mbi të cilën bazohet qeverisja e Ferizajt mbetet korniza afatmesme buxhetore 2012-2014, ku linjat për investime kapitale që mbeten si mundësia më e mirë për krijimin e ambientit të favorshëm për zhvillim ekonomik, shpesh-herë pësojnë ridestinime ad-hoc dhe ndryshime drastike. Si rast për ilustrim, në kornizën afatmesme për vitin fiskal 2013 janë propozuar gjashtë projekte për sektorin e

rinisë në vlerë prej 579 mijë euro, kurse në buxhetin e vitit 2013 në këtë sektor parashikohen vetëm dy projekte në vlerë prej 180 mijë euro.

Gjatë muajit nëntor të vitit 2012, INPO duke vlerësuar se komuna e Ferizajt tashmë ishte 'stabilizuar' pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme dhe duke pasur parasysh mandatin jo të plotë të kryetarit Aliu, ka kërkuar nga zyra e kryetarit qasje në planin vjetor të qeverisë komunale të Ferizajt. Mirëpo përgjigjja në kërkesën e INPO-s ishte se ekzekutivi i komunës nuk e posedon një plan të tillë dhe se mund të shtjellojmë programin e qeverisë komunale të Ferizajt.

Mungesa e planit vjetor paraqet një problem, pasi që programi i qeverisë komunale të Ferizajt është pjesë e kapaciteteve humane dhe materiale që i ka lënë ish-kryetari Bajrush Xhemaili. Në këtë kontekst përfundimi i mandatit të ish-kryetarit Xhemaili dhe organizimi i zgjedhjeve të jashtëzakonshme ka rezultuar me një kryetar të ri të komunës së Ferizajt, i cili është i obliguar të hartoj platformë vjetore të qeverisjes dhe ta prezantoj atë para qytetarëve në mënyrë që të arsyetoj besimin që ka marr në zgjedhjet e jashtëzakonshme.

Plani vjetor është një hap i domosdoshëm për të konkretizuar mënyrën se si kryetari synon të punojë, objektivat e tij dhe mjetet që ka në dispozicion për ta realizuar programin që e kishte prezantuar gjatë fushatës zgjedhore, si dhe mënyrën se si do t'u përgjigjet ndryshimeve eventuale në mjedisin dinamik në të cilin vepron. INPO konsideron se qeverisja është një proces i ndërlikuar që kërkon planifikim dhe shkathtësi për të zgjedhur madje edhe afatet kohore për realizimin e projekteve, në vend të pritjes së zhvillimeve që në të shumtën e rasteve rezultojnë me vendime jo efektive.

Plani vjetor vetëm do të ndikojë në avancimin e punës së ekzekutivit me qëllim që ajo të jetë sa më e organizuar dhe funksionale, ndërsa për aq kohë sa ekzekutivi nuk ka plan vjetor do të mbetet i kufizuar në të tashmen, pa orientim të mirëfilltë të detyrave administrative për projektet që do të implementohen në të ardhmen dhe pa vlerësimin dhe zhvillimin e nevojshëm të burimeve njerëzore në përputhje me objektivat afatgjatë që komuna e Ferizajt synon të arrijë.

Përfundimisht mungesa e dy prej dokumenteve bazike, Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal dhe planit vjetor të qeverisë komunale, krijojnë dilemën nëse qytetarët e Ferizajt kanë zgjedhur apo jo kryetar të ri. Duke pasur parasysh se kryetari Aliu ende nuk ka prezantuar ndonjë platformë qeverisëse apo plan operativ për ndonjë fushë të caktuar, mund të konkludojmë se gjashtë mujori i kryetarit Aliu ka qenë pjesërisht i suksesshëm, pasi që ekzekutivi i ri i Ferizajt ende nuk ka prezantuar plane për të dëshmuar shkaputjen nga ish-kryetari Xhemaili dhe prezantimin e kapaciteteve të tij për ndryshim dhe zhvillim të mëtutjeshëm në qeverisjen e komunës së Ferizajt.

Derisa kryetari Aliu pretendon se po e vazhdon mandatin e Bajrush Xhemailit, nga ana tjetër vazhdon t'i prezantoj sukseset e tij në krahasim me qeverisjen pararendëse.